KËRKESË

PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR TË BESNIK PETRIT SULËS

GJYKATËS SË RRETHIT TË ELBASANIT

Krkuese: Rajmonda Sula, e bija e Hakiut dhe e Hedijes, datëlindja 1961, lindur e banuese në Elbasan., lagjja “28 nëntori”, pallati 120/4.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të Besnik Petrit Sulës në bazë të nen it 15 të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të republikës së Shqipërisë.

Me Besnik Sulën jam martuar me celebrim në vitin 1980 dhe nga martesa kam lindur 3 fëmijë. Në gusht të vitit 1996, Besniku iku klandestin në Itali. Komunikimi me të ka vazhduar rreth 6 muaj. Pas kësaj kohe deri më sot nuk jam lidhur me të. Në shkurt të vitit 1997, një shoku i Besnikut, i quajtur Fejzo, më njoftoi se Besniku ka vdekur (është djegur sipas tij) dhe kufomën e dinte ai se ku ndodhej. Gjithashtu Fejzoja më tha që, sa të krijohen mundësitë, do t’i sillte në Shqipëri eshtrat e Besnikut. Që atëherë nuk di asgjë më tepër.

Në këto rrethana kërkoj që Besnik Sula të shpallet i zhdukur në bazë të ligjit.

KËRKUESE
Rajmonda Sula